

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	NATO gati t'u përgjigjet sulmeve hibride ruse, SHBA-të i kërkojnë Evropës të mbrojë veten
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/nato-gati-tu-pergjigjet-eve-hibride-ruse-shba-te-i-kerkojne-evropes-te--i588204
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 19:34:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 19:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9b6c7b97619d520d434d12c98cf4a77b6644e372f023ff01182f43618a076d91
TEKSTI	8fa526f7aa3d4e6e27463e5de86b364e6d1c9c93b8657002f8dd7b23fd48ea5c
PAMJA	92665790578d248cdf005858555e9eb43240f087005f2689f03c1858e0c348

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8dad88a032a6896f96e71d824cf88302e149d327bca4d0793f8dbb1c598b5f1d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c406e3f4a37e76aa776ac36276272ef42aa1461296b5cb3dea2e85e36f4d98cc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8dad88a032a6896f96e71d824cf88302e149d327bca4d0793f8dbb1c598b5f1d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



Incidenti i Viora Hysenit me gazetaren, T'abaku: Institucionet ne sherbim te interesave personale, ky sistem duhet çmontuar Viora Hyseni na tha te gjithëve: "Nuk kam n fundit

NATO gati t'u përgjigjet sulmeve hibride ruse, SHBA-të i kërkojnë Evropës të mbrojë veten



24 Shtator 2026, 21:45 Bota TEMA



Shefi i NATO-s, Mark Rutte, ka deklaruar se aleanca është plotësisht e gatshme t'u përgjigjet sulmeve hibride dhe sabotazheve ruse në Evropë, pas paralajmërimeve të reja nga shërbimet inteligjente daneze.

Ndërkohë, Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, u ka bërë thirrje aleatëve evropianë që të marrin më shumë përgjegjësi për mbrojtjen e kontinentit të tyre.

Gjatë një aktiviteti në Nju Jork për përkujtimin e sulmeve të 11 Shtatorit, Rutte theksoi se NATO ka në dispozicion të gjitha opsionet e nevojshme të përgjigjes për të përballuar kërcënimet në fushat kibernetike dhe të tjera hibride.

Sipas tij, shpeshtimi i këtyre incidenteve tregon se Presidenti rus Vladimir Putin është në një pozitë të vështirë dhe po humbet luftën në Ukrainë, e cila tashmë ka hyrë në vitin e saj të pestë. Rutte u bëri thirrje vendit anëtar të rritin mbështetjen për Ukrainën për t'i dërguar një sinjal të qartë Moskës.

Paralajmërimi i Rutte erdhi pasi inteligjenca daneze njoftoi për një rrezik në rritje të veprimeve ushtarake ruse ndaj vendeve të NATO-s. Po ashtu, mediat spanjolle raportuan se inteligjenca amerikane ka alarmuar disa shtete evropiane për operacione të mundshme me dronë rusë me shënjestër Spanjën, Francën ose Italinë.

Nga ana tjetër, gjatë takimit të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, prezantoi konceptin "NATO 3.0". Ai kërkoi që aleanca të kthehet në një strukturë të fortë ushtarake ku evropianët marrin rolin kryesor në mbrojtjen konvencionale të kontinentit të tyre.

Kjo kërkesë vjen pasi Uashingtoni njoftoi aleatët se nuk do të sigurojë më disa anije luftëra dhe avionë në rast të një sulmi ndaj një anëtari të NATO-s, duke i shtyrë vendet evropiane dhe Kanadanë të kërkojnë mënyra për mbulimin e këtyre mangësive. Sidoqoftë, SHBA nuk planifikon të tërheqë armët e saj bërthamore të vendosura në Evropë, të cilat mbeten shtylla kryesore e mbrojtjes dhe parandalimit të NATO-s.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Problemi me emigracionin në Mbretërinë e Bashkuar/ Home Office regjistron 781 hyrje në një ditë, numri më lartë gjatë 2026-ës](#)

21:05 Bota

Kompania që i shiti Pentagonit softuer për hakimin e telefonave fshehu pronësinë ruse


20:45 Bota

Xi i drejtohet Trumpit: Le të bashkëjetojmë në paqe, konkurrenca duhet të ketë kufij

20:15 Bota

Alarm në Poloni/ Evakuohen pikat kufitare, avionët luftarakë në gatishmëri

19:55 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.